CCA & DRM
In the framework of EU Integration

ERGJENCAT

With the support of the Erasmus+ Programme of the European Union

# Jean Monnet Module: Disaster Risk Management in the framework of EU Integration

National, local and community disaster risk reduction in Albania

FAKULTETI EKONOMISË

UNIVERSITETI I TIRANËS

"The European Commission's support for the production of this publication does not constitute an endorsement of the contents, which reflect the views only of the authors, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein."




# MBROJTJA CIVILE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

# PËRMBAJTJA E PREZANTIMIT

1- Emergjencat Civile, historiku I tyre

2-Ligji nr.45, datë 18.7.2019,”Për Mbrojtjen Civile”, risitë që ai sjell.

3-Sistemi i menaxhimit të Mbrojtjes Civile.

a-Pergjegjsite në nivelin Kombëtar.
b-Pergjegjesite në nivel Qarku/Bashkie/NjQV.

4-Strukturat e gatishmerisë dhe skemat e grumbullimit të informacionit dhe lajmerimit.

5-Drejtimi dhe strukturat oeracionale në nivelin kombetar.

6-Drejtimi dhe strukturat oeracionale në nivelin lokal.

# Emergjencat Civile ne vite

**-Ne vitin1964 krijohet ligjerisht Sherbimi i Mbrojtjes Civile nen Ministrine e Brendeshme**

**-Me vone Mbrojtja Civile kthehet ne nje strukture ushtarake me:**

- **6 nensherbime (Alarmi Ajror, Erresimi i dritave, Shpetim/evakuimi, MKK e popullsise, planifikimi e kontrolli i punimeve mbrojtese/strehuese, MNZ)**

- **4 lloje forcash operative (trupat e mbrojtjes nga ADM, grupet e shpetimit ne ndermarrjet ekonomike, repartet e MNZ, FA te RSh).**

**Fokusim ne mbrojtjen e popullsise nga lufta dhe fatkeqiste industriale**

**Zbatimi i sistemit te Komandes e Kontrollit lehtesonte gjetjen e resurseve por jo racionalizimin e tyre**







# Emergjencat Civile ne vite

- **Kriza kosovare krijoi nje eksperience shume te vyer ne menaxhimin e Emergjencave Civile**
- **Nje ligj i ri permbledhes "Per Emergjencat Civile" doli ne vitin 2001 dhe qe:**
  - **Ngre mbi baza ligjore Sherbimin Shqiptar te Emergjencave Civile**
  - **Percakton Sistemin e Planifikimit, Parandalimt dhe Parapergatitjes ndaj EC**
  - **Koordinon linjat e drejtimit te operacioneve per perballimin e EC**



- **Nje strukture e re qendrore e lokale, dhe jo ushtarake, per menaxhimin e EC.**
- **Partneriteti me Shoqerine Civile – metode qe fitoj terren.**
- **Me shume zhvillim – me teper prekshmeri ndaj emegjencave**



# LIGJI NR. 45, DATË 18.7.2019, "PËR MBROJTJEN CIVILE"

## Risitë e Ligjit të ri.

*Përcakton Strategjinë Kombëtare për Reduktimin e Riskut të Fatkeqësive si dokumentin bazë strategjik të RSH, reflektimi i gjetjeve të përvitshme të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, objektivi i pestë i Kuadrit Sendai, detyrimin për hartimin e Strategjisë të Zvogëlimit të Riskut ndaj Fatkeqësive për çdo NJQV.*

*Ndan detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve, të subjekteve private, të organizatave dhe shoqatave të shoqërisë civile dhe të shtetasve në tërësi, bashkë me detyrimet specifike që lidhen me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, të parashikuara në përputhje me Kuadrin Sendai.*

*Planet e emergjencave civile në nivelin qendror, në prefekture, në nivel bashkie/njësitë administrative dhe subjekteve private.*

*Vendos tavane për përqindjen e buxhetit për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive dhe për mbrojtjen civile në 2 - 4%në ministritë e linjës dhe 4% e buxhetit për bashkitë.*

*Vendos sanksione të qarta për të gjithë institucionet publike, por edhe subjektet private, sikurse përcakton qartë edhe funksionimin e mekanizmit të inspektimit.*

*Mundëson krijimin e një baze të të dhënave të fatkeqësive në të treja nivelet, në atë qendror, të prefekturës dhe vendor.*

# HARTIMIN I AKTEVE NëNLIGJORE NË ZBATIM TË NENIT 72, PIKA 1, TË LIGJIT NR. 45/2019 "PËR MBROJTJEN CIVILE

16 Vendime te Keshillit të Ministrave

- Janë miratuar 6 VKM

- Kanë Perfunduar draftet fillestare të 10 VKM-ve

Janë për miratim 3 Urdhra të Kryeministrit për:

- Përgatitjen e Strategjise Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut

- Përgatitjen e Dokumentit të Zvogëlimit të Riskut

- Përgatitjen e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile

## Niveli Qendror

**KUVENDI I R. SH**

**KESHILLI I MINISTRAVE**

Komiteti i Mbrojtjes Civile

**Komiteti Ndërministror i Emergjencat civile**

Drejtuesi Qendror i Operacionit. (Ekipi I Menaxhimit te Emergjences)

- Ministria e Mbrojtjes
- Ministritë/inst.Qendrore
- Agjencia Kombetare e MC
- Komisioni Teknik Këshillimor
- Qendrat e Mbrojtjes Civile

## Kuvendi

- miraton buxhetin e AKMC-së, si pjesë e buxhetit të ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen civile
- ushtron kontroll parlamentar për çështje që kanë lidhje me mbrojtjen civile.
- ratifikon marrëveshje ndërkombëtare mbi mbrojtjen civile.
- vendos për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë përtej 30 ditëve të shpallura nga Këshilli i Ministrave.

## Këshilli i Ministrave

Miraton dhe siguron zbatimin e politikave për zvogëlimin e riskut dhe mbrojtjen civile në RSH dhe ka këto përgjegjësi:

- miraton Strategjinë Kombëtare për zvogëlimin e riskut , Planin Kombëtar për EC, vlerësimin e riskut në nivel qendror;
- mund të vendosë për një periudhë ≤30 ditë, gjendjen e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e vendit;
- informon Kuvendin e RSH për situatën e krijuar, rreziqet që paraqiten dhe masat e marra për menaxhimin e situatës, si dhe kërkon pëlqimin e tij për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë përtej 30 ditëve.

## Komiteti I Mbrojtjes Civile

- Është organi më i lartë, i përhershëm, përgjegjës për zbatimin e politikave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në Republikën e Shqipërisë
- Zyra përgjegjëse për situatën/strukturë pranë Kryeministrit

## Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile

**Me shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore/organi më i lartë për koordinimin dhe bashkërendimin e veprimeve të institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, si dhe të burimeve materiale e financiare për përballimin e fatkeqësisë natyrore**

- Bashkërendon gjithë veprimtarinë e institucioneve dhe të strukturave të mbrojtjes civile.
- Përcakton mënyrat dhe procedurat për përdorimin e burimeve materiale e financiare
- Vendos shpërndarjen e fondeve për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore.
- cakton drejtuesin qendror të operacionit për menaxhimin e fatkeqësisë natyrore.

- Ministri përgjegjës për mbrojtjen civile

- Ministri përgjegjës për mbrojtjen civile ka këto përgjegjësi:
  a) përcakton drejtimet strategjike dhe objektivat e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;
  b) harton dhe mbikëqyr zbatimin e politikave të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe të mbrojtjes civile;
  c) informon, periodikisht, Këshillin e Ministrave në lidhje me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile;
  ç) mbikëqyr menaxhimin e buxhetit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, sipas legjislacionit financiar në fuqi.

## Ministritë dhe institucionet qendrore

**Çdo ministër dhe drejtues institucioni qendror është përgjegjës për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore apo të kompetencave të tyre.**

## AKMC

Institucion qendror në varësi të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile dhe përgjigjet për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në të gjithë territorin e RSH.

**AKMC-ja** ushtron autoritet koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

- Zbaton drejtimet strategjike dhe objektivat e përcaktuara nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen civile
- koordinon dhe bashkërendon punën për hartimin e Strategjisë Kombëtare për zvogëlimin e riskut , Planit Kombëtar për EC dhe Vlerësimin e Riskut nga Fatkeqësitë në nivel qendror;
- bashkëpunon me organizmat ndërkombëtare dhe organizatat homologe ndërkombëtare në kuadër të zvogëlimin e riskut &mbrojtjen civile.
- nëpërmjet Qendrës së Trajnimeve për mbrojtjen Civile kryen trajnimet e strukturave shtetërore, subjekteve private dhe vullnetare
- lidh marrëveshje me organizata jofitimprurëse, ose subjekte të tjera juridike në lidhje me mbrojtjen civile…….

**Qendrat e Mbrojtjes Civile në Qark,** **4** degë territoriale në varësi të AKMC-së që përbëjnë rrjetin institucional të specializuar, që zbatojnë detyrat për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në qark.

## Prefekti i qarkut:

- Kryerja e vlerësimit të risqeve në territorin e qarkut përkatës,
- Miratimi dhe përditësimi i Planit për EC në qark,
- Krijimi i DLD në nivel qarku.
- Sigurimi i funksionimit të sistemit të monitorimit, paralajmërimit të hershëm, njoftimit dhe alarmit në territorin e qarkut.
- koordinon shpërndarjen e asistencës ndërkombëtare në rastet e fatkeqësive në nivel qarku;
- koordinon forcat operacionale në nivel qarku në rastet e fatkeqësive dhe cakton drejtuesin e operacionit në nivel qarku.
- monitoron zbatimin e masave të marra nga bashkitë e qarkut për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile;

## Njësitë e vetëqeverisjes vendore:

- Hartimi i vlerësimit të risqeve nga fatkeqësisë,
- Hartimi dhe rishikimi i Strategjisë për DRR
- Hartimi, miratimi dhe përditësimi i Planit Vendor për EC
- Krijimi i bazës së të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë
- Sigurimi i funksionimit të sistemit të monitorimit, paralajmërimit të hershëm, njoftimit dhe alarmit në territorin e tyre.
- kryejnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi të ndryshme në territorin e tyre

# Institucionet dhe strukturat vendore të mbrojtjes civile:



# FORCAT OPERACIONALE



Forcat e Armatosura



Policia e Shtetit




SHMNZSH



Qendra Kombëtare Operacionale e EC



Shërbimi i Vullnetarëve




Shërbimi i Urgjencës Mjekësore

# Strukturat e gatishmërisë për emergjencat civile



## *AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE*




KM DEKLARON EMERGJENCEN
PLANI KOMBETAR PER EC)
KNEC DREJTUESI I OPERACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE KESHLLON MM
REAGIMI I PUSHTETIT LOKAL
MBESHTETJA NGA STRUKTURAT QENDRORE
REAGIMI I STRUKTURAVE QENDRORE
PREFEKTI KERKON NDIHME NGA INSTITUCIONET QENDRORE
BURIMET JANE AKTIVIZUAR
AGJENCI NDERKOMBETARE

# PLANI KOMBETAR PER EMERGJENCAT CIVILE

(Miratuar me VKM nr. 835, dt. 3 Dhjetor 2004)

***Plani Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC) është dokumenti kryesor i politikave të shtetit shqiptar në fushën e emergjencave civile***

*__Synimet,__*

**Të parandalohet, të lehtësohet dhe të riaftësohet nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile.*

• *Të sigurohen kushtet për institucionet shtetërore, publike dhe private, për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në një situatë emergjente, me humbje sa më të vogla për ruajtjen e rendit, për jetën e njerëzve, për gjënë e gjallë, për pronën, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin, ndaj efekteve të një emergjence civile.*

• *Të garantohet përdorimi i të gjitha burimeve të mundshme të shtetit me qëllim sigurimin publik,ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë kombëtare, lokalizimin e zonës së emergjencës dhe lehtësimin e pasojave*

***PKEC-ja, në thelb, është mjet bashkërendimi, i cili, nëse përdoret në mënyrë korrekte,***

- *do të shpëtojë jetë njerëzore dhe pasuri,*
- *do të rritë ndikimin e kapaciteteve ekzistuese,*
- *do të sigurojë mjetet për kërkimin e burimeve dhe të ndihmës shtesë.*



# Fazat e ciklit të menaxhimit të E.C (PKEC)




## Parandalimi dhe lehtesimi



## Përgatitja dhe mbrojtja



## Përgjigjja



## Rikthimi në gjendje normale

# Parandalimi dhe lehtësimi

➡ masave për shmangien e situatave të emergjencave civile që mund të prekin jeten, pasurine dhe trashegimine kulturore.



➡ masave për zvogelimin e prekshmerise sociale, ekonomike dhe mjedisore ndaj dukurive të mundeshme të rrezikut, që mund të vijnë nga fatkeqesite natyrore dhe fatkeqesi të aktivitetit njerezor.



# Përgatitja dhe mbrojtja

→ masa për të përgatitur njerezit dhe mjedisin që të perballojne në menyre sa me efektive të mundeshme efektet e nje kercenimi ose rreziku të mundshem të indedifikuar.

-Institucionet dhe planet e emergjencave.

-Planet sektoriale të emergjencave dhe gadishmerise

-Indetifikimi i rreziqeve te mundeshme

-Informim dhe ndergjegjesim mbi rreziqet

a. Fushat e ndergjegjesimit publik dhe te edukimit

b. planet

c. stervitjet

-Monitorimi dhe mekanizmat aktive.

-Punët publike emergjente dhe masat e menjehershme

-Rolet dhe përgjegjesitë;

Në nivelin Kombëtar,

në nivel Qarku,

në nivel Bashkie e Njësia Administrative.





# Përgjigjja

Përgjigjja është tërësia e veprimeve të forcave dhe të mjeteve për shpetimin e jetes së njerezve, gjësë së gjallë dhe të vlerave materiale(prones) në nje territor të prekur nga fatkeqesia.

**FAZA E PERGJIGJES KALON NË KËTO ETAPA:**

***Etapa e pare:** "Alarm për rritjen e gadishmerise" është tëresia e masave për njoftim paraprak pas marrjes së informacionit qe mund të lind një situatë emergjente.

***Etapa e dyte**: "Gadishmeria" është tërësia e masave për njoftim paraprak, pasues, pas informacionit që një situatë emergjence është e afert ose në zhvillim.

***Etapa e trete:** "Aktivizimi" është kur një situatë emergjence ka ndodhur realisht.

***Etapa e katert**: "Dalja nga situata" është mbyllja e fazës së pergjigjes, pavaresisht sesa etapa të mëparëshme kanë ndodhur realisht.

# Rikthimi në gjendje normale

Marrja e masave për të siguruar që jeta dhe prona e komunitetit të prekur të rivendoset në të njejtin nivel si edhe përpara situate së emergjences civile.

-Bashkërendimi dhe informacioni,

-Largimi ose zvogelimi i rreziqeve direkte,

-Stabilizimi i pasojave që vijne nga burime dytësore rreziku,

-Proçedurat për kthimin e sigurte dhe aktivitetin normal,

*Kontrolli i parametrave të sigurise
*Hyrje – dalje të sigurta
*Sigurimi i strehimeve provizore
*Informimi publik
*Informacion paralajmerues
*Shendeti publik
*Grupet me të prekeshme/të cenushme
*Sherbimet publike
*Lidhjet familjare




# Rrethi i Menaxhimit te Emergjencave

# Objektivi Perfundimtar



# Ju faleminderit për vëmendjen.

# PYETJE?